

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Programi i Transparencës i Rishikuar

Rishikimi i programit të transparencës nuk është vetëm një detyrë ligjore e parashikuar në nenin 5 të ligjit "Për të drejtën e informimit" por edhe një kërkesë e qytetarëve, shoqërisë civile dhe vetë autoriteteve publike për të pasur një program model, i cili duhet të jetë i qartë dhe lehtësisht i arritshëm për të gjithë. Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit hartoi modelin e ri të programit të transparencës, duke specifikuar për çdo kategori informacioni dokumentacionin konkret që do të publikohet në kategorinë specifike dhe gjithashtu duke krijuar një program të ri të transparencës miqësor në internet. Programi i ri i transparencës i cili u miratua me Urdhrin e Komisionerit nr. 187, datë 18.12.2020 "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar" dhe u publikua në Fletoren Zyrtare me nr. 224 datë 22.12.2020. Programi i transparencës i rishikuar, duhet të zbatohet nga të gjitha autoritetet publike, me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se data 31 mars 2021. Ky program është i ndarë në 12 kategori kryesore dhe çdo kategori përmban nënlidhje me informacionin e kërkuar nga neni 7 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Programi i rishikuar i transparencës duhet të publikohet nga autoritetet publike në faqet e tyre zyrtare në formë e përmbajtje si modeli i dërguar me cd nga Zyra e Komisionerit.



Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 1 - Parimi i konfidencialitetit në një kontratë publike lidhet me aspekte teknike, sekret tregtare apo informacion të ofertave dhe jo me gjithë kontratën publike në tërësinë e saj.

Rekomandime për 20 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore - Plotësimi me informacion të të gjitha kategorive të Programit Model të Transparencës të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit janar, ka dhënë 1 vendim urdhërimi dhe 20 rekomandime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) dhe ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Me anë të Vendimit nr. 1, datë 18.01.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ku kërkohej kopja e plotë (përfshirë anekset dhe hartat e mundshme) të kontratës së nënshkruar midis MIE dhe kompanisë fituese të konkursit për Parkun Fotovoltaik të Karavastasë (140 MW).

Në ndjekje të procedurave administrative me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, KDIMDP ftoi palët në një seancë dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KDIMDP, në prani të dy palëve përfaqësuesit e MIE rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore sipas të cilave: "Në nenin 22 të kontratës së zhvillimit të projektit me shoqërinë fituese e nënshkruar më datë 31 korrik 2020, përcaktohet "Në zbatim të përjashtimeve të parashikuara në nenet 22.2 dhe 22.3, nga data e nënshkrimit deri në përfundimin apo zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje ose brenda një periudhe njëvjeçare pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje, asnjë nga palët nuk nxjerr apo lejon që oficerët, punonjësit, agjentët apo kontraktorët e saj të zbulojnë përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje ose çdo informacion konfidencial tregtar lidhur me negociatat rreth kësaj marrëveshjeje të cilat mund t'i jenë bërë të njohura palës gjatë zhvillimit të negociatave të tilla apo lidhur me veprimet, kontratat, marrëveshjet tregtare apo financiare ose çështje të palës tjetër, pa marrë miratimin e palës tjetër." Gjatë seancës dëgjimore Autoriteti Publik rikonfirmoi qëndrimin e tij si dhe sqaroi ndër të tjera se: "...Nga ana e Autoritetit Publik është ndjekur procedura e parashikuar, duke e vënë në dijeni palën kontraktuese, e cila është shprehur se shumë pjesë të kontratës konsiderohen me sensitivitet të lartë tregtar (për të cilat duhet ruajtur konfidencialiteti). Në këto kushte, nëse "MIE" nuk respekton apo shkel nenet e kësaj kontrate (pa miratim apo marrëveshjen paraprake me palën kontraktuese), shoqëria fituese mund t'i drejtohet arbitrazhit ndërkombëtar".

KDIMDP vlerëson se dispozita e sipërcituar nuk është vendosur në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

burimet e rinovueshme" dhe VKM nr. 349, datë 12.06.2018 "Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre".

Në asnjë nga dispozitat e parashikuara në legjislacionet e sipërcituara, mbi të cilat është zhvilluar procesi konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e projektit, nuk ka ndonjë parashikim lidhur me konfidencialitetin e kontratës dhe dokumentacionit të saj shoqëruar. Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore Autoriteti Publik nuk provoi se është përpara kufizimeve të nenit 17 të LDI.


Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik për mosdhënien e informacionit nuk rezulton i bazuar në ligj. Për më tepër, edhe nëse do të kishte aspekte konfidenciale, në frymën e pikës 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim". Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të kontratës të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tyre. Konfidencialiteti lidhet me aspekte teknike, sekrete tregtare dhe të dhëna të tjera konfidenciale me të cilat Autoriteti Publik është njohur ose i janë vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë gjatë procesit konkurrues dhe jo me të gjithë kontratën publike në tërësinë e saj. Pra, në këtë përcaktim nuk përfshihet kontrata publike e cila edhe nga vetë emri është vetëshpjeguese për natyrën e saj.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.



INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE TË VARËSISË




KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Indeksi i Transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë

Gjatë vitit 2020, Zyra e Komisionerit ka vijuar me monitorimin online të zbatimit të Programit Model të Transparencës, Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve dhe të Dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit nga ana e gjithë autoriteve publike.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka sjellë një metodologji të re të monitorimit të transparencës proaktive duke prodhuar dy raporte: Raporti i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Raporti i Transparencës Proaktive të Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë, si dhe indekset respektive të transparencës proaktive.

Monitorimi i institucioneve qendrore dhe të varësisë, i cili ndjek një metodologji monitorimi të ngjashme me atë të raportit mbi transparencën proaktive të NJVV duke i shtuar një indikator të ri (publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2020) është pilotuar në 36 autoritete publike duke përfshirë këtu Kryeministrinë, Ministrinë dhe disa institucione në varësi të ministrive.



INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE DHE TË VARËSISË



Rezultatet e këtij monitorimi u publikuan në faqen zyrtare të Komisionerit në muajin janar të vitit 2021. Këto rezultate tregojnë se janë 32 autoritete publike qendrore dhe të varësisë që kanë publikuar “Programin Model të Transparencës (qoftë edhe formalisht)” sipas Urdhrit nr. 14 datë 22.01.2015 “Programin Model të Transparencës”, i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga autoritetet publike, çka përbën rreth 89% të autoriteteve publike pjesë e monitorimit. Në të njëjtën tendencë është edhe indikator i “Publikimit të të Dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit” me 30 autoritete publike qendrore dhe të varësisë të cilat e kanë publikuar, çka përbën 83% e totalit të autoriteteve publike.

Në lidhje me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, monitorimi evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar gjatë vitit 2020. Numri total i autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve është 19, çka përbën 53% të autoriteteve publike që kanë zbatuar detyrimin ligjor për përditësimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve. Ndërkohë, që 14 autoritete publike (39%) kanë instaluar dhe janë bërë pjesë e Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit (REKPD).

Indikator i cili rezulton me performancën më të ulët është indikator “Publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2020”, ku vetëm 8 autoritete publike e kanë publikuar, çka përbën 22% të totalit të autoriteteve publike pjesë të këtij monitorimi.

Për sa i përket indeksimit të transparencës proaktive midis autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, sipas monitorimit rezulton se 2 autoritete publike (5%) kanë “Transparencë Proaktive Negative” (semafor i kuq), pra i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar 0 pikë; 6 autoritete publike (17%) kanë “Transparencë Proaktive të Pamjaftueshme (semafor i verdhë), sepse kanë 1 nga 4 treguesit e monitorimit pozitiv, ndërsa 3 të tjerët janë vlerësuar me 0 pikë; 23 (64%) autoritete publike kanë “Transparencë Proaktive Minimale (semafor i bardhë), sepse kanë minimumi 2 tregues pozitiv dhe maksimumi 4 tregues pozitiv, si dhe 5 autoritete publike (14%) kanë “Transparencë Proaktive Funktionale” (semafor i gjelbër) sepse kanë të gjithë treguesit pozitiv.